

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. Regj.Themeltar 798

Datë 19.05.2017

Data e Regj.27.04.2017

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQTARE: REXHINA MERLIKA

asistuar nga sekretare gjyqësore Manjola Islamaj, sot më datë 19.05.2017, mori në shqyrtim çështjen penale me Nr.798Regj.Themeltar, që i përket :

KËRKUES: Shoqëria Përmbarimore “K... B... S...” sh.p.k, me përmbarues privat E. K., me adresë Rr.”...” Kulla 3, Shk.3, Kt.2 Nr.4, Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga Av.Indrit Sefa, sipas autorizimit Nr.934/19 Prot. datë 04.05.2017.

KUNDËR Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar me autorizim nga prokurore Suela Salavaci.

OBJEKTI: Kundërshtim i Vendimit të Prokurorisë për sekuestrimin e Dosjes Përmbarimore, datë 12.04.2017, referuar me anë të shkresës me Nr.2769Prot. të Prokurorisë së Tiranës

BAZA LIGJORE : Neni 212 dhe ne vazhdim të K.Pr.Penale.

Gjykata pasi u njoh me materialet e çështjes, dëgjoi palën ankuese e cila kërkoi Rrëzimin e Vendimit të Prokurorisë së Tiranës , datë 12.04.2017, “Për sekuestrimin në origjinal të dosjes përmbarimore me Nr.1101-16, pranë “K... B... S...” sh.p.k., prokuroren e cila kërkoi mospranimin e ankimit,

V Ë R E N

Pala Ankuese Shoqëria Përmbarimore “K... B... S...” sh.p.k i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me ankimin kundër vendimit të Prokurorisë për sekuestrimin e

Dosjes Përmbartimore, datë 12.04.2017, referuar me anë të shkresës me Nr.2769Prot. të Prokurorisë së Tiranës.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka nisur procedimin penal Nr. 2769, për veprat penale të « Fallsifikimit të dokumentave » dhe « Mashtrimit në kredi » të parashikuara nga nenet 186 dhe 146 të Kodit Penal. Me qëllim hetimin e plotë e të gjithëanshëm, nga prokurorja është çmuar si e nevojshme të sekuestrohet në origjinal dosja përmbartimore Nr.1101-16 për vënien në ekzekutim e Urdhërit të Ekzekutimit Nr.7260 akti datë 21.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë kreditore Veneto Bank sh.a dhe palë debitore E. A. K.me objekt « Kthim shume » për të cilën është filluar procedura përmbartimore, nga përmbartuesi gjyqësor privat E. K., pranë shoqëria « K... B... S... » shpk.

Nga pala ankuese është pretenduar se ky veprim është në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në K.Pr.Penale dhe një veprim i tillë nuk mund të sjellë asnjë provë të re këtij hetimi të cilat mund të gjenden në institucionet të tjera.Ai edhe pse është marrë në mbështetje të dispozitave të legjislacionit, është i tepërt dhe nuk i shërben hetimit në lidhje me veprën penale e cila nuk ka asnjë lidhje me dosjen përmbartimore dhe me ekzekutimin e saj.Në dosjen përmbartimore është e domosdoshme të jenë këto dokumenta si; titulli ekzekutiv(në origjinal ose i noterizuar); urdhëri i ekzekutimit (origjinal); pagesën e tarifës sipas paragrafit të parë të nenit 525 të këtij Kodi; sipas rastit prokura e përsoneit që përfaqëson palën kreditore.

Ndërkohë që në bazë të nenit 513 të K.Pr. Civile urdhëri i ekzekutimit lëshohet vetëm në një kopje.Në këto kushte procedura përmbartimore ka qënë në vazhdim në referim të dispozitave të K.Pr.Civile.Ky sekuestrim ka sjellë si pasoje pezullimin e ekzekutimit, pasi nuk lejohet për asnjë rast që përmbartuesi gjyqësor të vazhdojë ekzekutimin e vendimit pa akte origjinale. Ky pezullim vjen në kundërshtim me nenin 615 të K.Pr.Civile. Në asnjë nga veprat penale për të cilat heton prokuroria nuk mund të gjenden provat unike me praktikën përmbartimore, ato mund të merren fare mirë pranë noterëve publikë si dhe prova te tjera, pasi dokumenti unik pa të cilin nuk mund të vazhdojë ekzekutimi është urdhëri i ekzekutimit.Më këtë veprim ky organ ka tejkaluar kompetencat e tij edhe në referim me nenin 208 të K.Pr.Penale.

Ndërsa nga ana e prokurores u pretendua se : *Ne konstatojmë se e gjithë procedura qoftë nga banka është bërë duke konsumuar nje vepër penale, jemi të detyruar të ndalojmë pasojat dhe për këtë duhet të bënim sekuestrimin e dosjes. Nëse vazhdon me procedurën përmbartimore do ishte dëm i pariparueshëm. Edhe kreditori e ka të qartë lidhur me kredinë dhe s'mund të nxjerrë probleme. Dëmi që mund të vijë do jetë më i madh dhe i pariparueshëm. Hetimi ka rreth 2 muaj që vazhdon, por ka shumë veprime për të kryer.*

Gjykata në rastin në gjykim i referohet dispozitave të K.Pr.Penale, Kreut të III « Mjetet e Kërkimit të Provës » dhe seksionit III « Sekuestrimet »konkretisht nenit 208 e

vijues sipas të cilit parashikohet se : *“Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. 2. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim. 3. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, në qoftë se është i pranishëm”*.

Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se sekuestrimi i provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale është disponim në kompetencë të prokurorit, në kushtet kur sekuestrimi i tyre është i domosdoshëm për të vërtetuar faktet që lidhen me veprën penale. Kjo vendimarrje e prokurorit për kryerjen e sekuestrimit, duhet të jetë në përputhje me kuptimin e provës materiale, neni 187 i K. Pr. Penale dhe sendeve që lidhen me veprën penale. Kështu, objekt i sekuestrimit janë: sendet që kanë sherbyer si mjet për realizimin e veprës penale; sendet mbi të cilat gjenden gjurmët e veprës penale; sendet që kanë qenë objekt i veprimtarive të të pandehurit, sendet që përbëjnë objektin e përfutur nga vepra penale si dhe; sende që lidhen me veprën penale, siç mund të jenë ato sende që ndihmojnë në sqarimin e rrethanave të çështjes etj. Ne rastin konkret sekuestrimi është realizuar nga prokurorja për marrjen e provës materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale, gjatë veprimeve hetimore, duke çmuar prej saj se i shërben hetimit të plotë dhe të gjithanshëm të procedimit penal Nr.2769 të vitit 2017 për veprat penale të « Fallsifikimit të dokumentave » dhe « Mashtrimit në kredi » të parashikuara nga nenet 186 dhe 146 të Kodit Penal.

Rezulton se nga ana e prokurores pas marrjes së këtij vendimi është respektuar procedura duke i dorëzuar të interesuarit kopjen e vendimit, për t'i garantuar atij të drejtën e ankimit në gjykatë. Kjo e drejtë është realizuar nga pala ankuese në përputhje nenin 212 të të K. Pr. Penale, por që nuk pezullon zbatimin e vendimit.

Nga provat e paraqitura nga pala ankuese gjykata konstaton se veprimet e përmbauesit gjyqësor privat në fazën e ekzekutimit lidhen më titullin ekzekutiv “Kontratë kredie bankare “ Nr.... , datë 09.04.2015 për të cilën është lëshuar urdhëri i ekzekutimit me Vendimin Nr.... akti datë 21.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë kreditore Veneto Bank sh.a dhe palë debitore E.A. K..

Mbi bazën e kërkesës së palës kreditore Venteo Bank sh.a, shoqëria përmbauese “K... B... S...” ka nisur procedurën e ekzekutimit duke lajmëruar për ekzekutim vullnetar të detyrimit sipas shkresës Nr.2254/2 datë 22.12.2016, palën kreditore, debitore, hipotekuesin.Më pas ka vijuar me njoftim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të udhërit të ekzekutimit sipas vendimit Nr. Nr.78Prot. datë 05.01.2017 dhe urdhërimin e sekustros konservative në gjithë Bankat e Nivelit të Dytë në llogaritë rrjedhëse, depozitat dhe kreditë e debitorit si dhe mbi pasuritë e debitorit në ZVRPP etj. Në kushtet kur nuk është arritur një marrëveshje për përcaktimin e vlerës së sendit të sekuestruara nga përmbauesi është kaluar në fazën e përcaktimit të vlerësimit të sendit të sekuestruar nga eksperte vlerësueses i pasurive të paluajtshme sipas vendimit Nr.207/3 datë 01.03.2017, procedurë e cila është në vazhdim.

Gjatë fazës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është bërë kallëzim penal nga shtetasi S. S., mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal Nr.2769 për veprat penale të “Fallsifikimit të dokumentave dhe “Mashtrimit me kredi” të parashikuara nga nenet 186 dhe 146 të Kodit Penal.

Gjykata konstaton se sekuestrimi në origjinal i dosjes përmbare Nr.1101-16 për vënien në ekzekutim e Urdhërit të Ekzekutimit Nr.7260 akti datë 21.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë kreditore Veneto Bank sh.a dhe palë debitore E. A. K.me objekt « Kthim shume » për të cilën është filluar procedura përmbare, nga përmbaresi gjyqësor privat E. K., pranë shoqëria « K... B... S... » shpk i shërben dhe ka lidhje të drejtëpërdrejtë me hetimin e veprave penale, duke bërë të mundur që nëpërmjet këtij sekuestrimi të ndalohen pasojat e rënda që mund të vijnë nga këto vepra penale, të cilat kanë lidhje me procedimin penal.

Në kushtet e hetimit të këtyre dy veprave penale, merr një rëndësi të posaçme e drejta publike, pra e cila garanton në tërësi mbrojtjen e interesave të ligjshme të palëve në kushtet e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv, kontratë kredie dhe hipotekimi, për të cilat ka të dhëna dhe dyshim të arsyeshëm se janë rezultat i veprimeve të kundraligjshme, në fushën e dhënies së kredive duke fallsifikuar dokumnta, me qëllim nxjerrjen e përfitimeve.Këto veprime dyshohet se janë kryer nga persona që në procesin marrjes së kredisë janë në cilësinë e kredidhënësit apo kredimarrësit dhe që në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm kanë cilësinë e kreditorit apo debitori etj.Faza e ekzekutimit të detyrueshëm është me shumë rëndësi, pasi nëse provohet se këto veprime janë të kundraligjshme dhe përbëjnë elemente të një veprave penale do të thotë që të lejohet kjo situatë dhe të vazhdojnë pasojat e saj.

Nga ana e prokurores janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit procedural penal, prandaj sekestrimi konsiderohet nga gjykata i ligjshëm dhe në këto kushte, ankimi i paraqitur nga Shoqëria Përmbare “K... B... S...” sh.p.k, është i pabazuar në ligj dhe në prova e si i tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 208 e 212 të Kodit të Procedurës Penale;

VENDOSI:

-Rrëzimin e kërkeses ankimore të kërkuesit Shoqëria Përmbare “K... B... S...” sh.p.k.

-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuesit.

-Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 10 diteve në Gjykatën e Apelit Tiranë,duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

U shpall sot më datë **19.05.2017** në Tiranë.

SEKRETARE

MANJOLA ISLAMAJ

GJYQTARE

REXHINA MERLIKA